



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria – Vlada – Government**

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*  
*Ministarstva za Obrazovanje Nauku i Tehnologiju*  
*Ministry of Education Science & Technology*

*Kabineti i Ministrit / Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister*

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet; 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, nenin 49 paragrafit 1 të Ligjit të Arsimit Parauniversitar (Gazeta Zyrtare nr. 17, dt. 16 shtator 2011), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcën 6 dhe neni 33.2 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (dt. 22.03.2011), nxjerr :

**UDHËZIM ADMINISTRATIV**

**Për kalimin e nxënësit të shkollës së mesme të lartë prej një profili arsimor në tjetrin ose prej një shkolle në shkollën tjetër**

Numër: 16/2011

Datë: 30.12.2011

**Neni 1**

**Qëllimi**

Me këtë Udhëzim administrativ përcaktohen të drejtat, obligimet, kriteret dhe procedurat e kalimit të nxënësit të shkollës së mesme të lartë, prej një profili arsimor në tjetrin, përkatësisht prej një shkolle në shkollën tjetër.

## **Neni 2**

### **E drejta e transferit**

1. Të drejtë kalimi prej një profili arsimor në tjetrin, përkatësisht prej një shkolle në shkollën tjetër, kanë të gjithë nxënësit e arsimit formal dhe joformal të shkollave të mesme të larta, publike dhe private të licencuara nga MASHT, të cilët:
  - 1.1. Ndërrojnë vendbanimin dhe në vendbanimin e ri nuk kanë shkollë të profilit përkatës;
  - 1.2. Për shkak të aftësive të kufizuara fizike, janë të detyruar të ndërrojnë profilin arsimor ose shkollën;
  - 1.3. Për shkak të reformës shkollore, nevojës së tregut, apo për arsye të ndryshme të ndërprerjes së procesit mësimor;
  - 1.4. Për shkak të mos përmbushjes të kompetencave në një fushë të caktuar mësimore.

## **Neni 3**

### **Kriteret**

1. Nxënësi mund të kalojë prej një profili arsimor në profilin tjetër arsimor apo prej një shkolle në shkollën tjetër nëse:
  - 1.1. Konstatohet nga DKA se shkolla ka vend për ta sistemuar nxënësin;
  - 1.2. Tregon sukses pozitiv në testin vlerësues për lëndët/fushat mësimore të cilat nuk i ka pasur në planin dhe programin mësimor në drejtimin që e ka vijuar;
  - 1.3. Në lëndët/fushat mësimore të cilat i ka mësuar në profilin e caktuar mësimor me përmbajtje programore më pak se 70% nxënësi duhet t'i nënshtrohet testit vlerësues dhe të tregojë sukses pozitiv;
  - 1.4. Në lëndët/fushat mësimore të cilat i ka mësuar në profilin e caktuar 70% e më shumë nuk i nënshtrohet testit vlerësues.
2. Nxënësi i klasës së dhjetë mund të ndërrojë profilin arsimor ose shkollën pa hyrë në testin vlerësues vetëm në periudhën e parë mësimore, por me kusht që në testin kombëtar të arritshmërisë të ketë pasur pikë së paku sa nxënësi i fundit i pranuar në atë profil arsimor në shkollën përkatëse.
3. Për nxënësit e klasës XI, XII testi vlerësues për lëndët mësimore plotësuese dhe diferenciale, përpilohet në mënyrë kumulative (të përmbledhura nga klasa X/XI/XII) sipas kriterëve të vlerësimit të paraqitura në kurrikul.
4. Vlerësimi i nxënësit bëhet nga ana e shkollës në të cilën nxënësi aplikon.
5. Sukses i treguar në testin e vlerësimit evidentohet në procesverbal, në librin amë të nxënësve dhe në pjesën e prapme të dëftesës së klasës/shkollës/nivelit të fundit, të cilën nxënësi e ka kryer para se të kalojë në këtë profil arsimor, përkatësisht shkollë.

## Neni 4

### Procedura

1. Kërkesën për të kaluar prej një profili arsimor në tjetrin, nxënësi e bën në mbarim të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor, (05-20 dhjetor), ose para fillimit të vitit të ardhshëm shkollor, (15-20 gusht).
2. Për kandidatët e arsimit joformal, drejtorja e shkollës merr vendim në bazë të dokumentacioneve që janë në fuqi.
3. Në raste kur nxënësi kthehet nga bota e jashtme, e ndërron vendbanimin ose për raste të tjera të jashtëzakonshme, ai mund të bëjë kërkesë edhe gjatë vitit shkollor, por më së largu deri në fund të muajit mars të vitit vijues.
4. Kërkesa i bëhet drejtorit të shkollës përkatëse. Kërkesës i bashkangjiten këto dokumente:
  - 4.1. Dëftesat për kryerjen e klasave paraprake;
  - 4.2. Nostrifikimi i dokumenteve;
  - 4.3. Dokumenti për arsyeshmërinë e ndërrimit të profilit arsimor ose shkollës;
  - 4.4. Preferenca e ekspertit të profilit përkatës;
  - 4.5. Vërtetimi i vendbanimit;
  - 4.6. Dëshmi për notat e marra deri në momentin e vazhdimit të shkollimit.
5. Për vendosjen lidhur me kërkesën, drejtori i shkollës merr mendimin paraparak:
  - 5.1. Nga MASHT-i pasi që Komisioni për Barasvlerë dhe Nostrifikim ta ketë bërë ekuivalencën (barasvlerën) e dëftesës për nxënësit që jetojnë jashtë Kosovës.
  - 5.2. Nga DKA pasi të ketë bërë ekuivalencën (barasvlerën) e dëftesës për nxënësit që jetojnë brenda Kosovës.
6. Nëse për kërkesën e nxënësit vendoset pozitivisht, atëherë drejtori i shkollës cakton komisionin vlerësues, vendin dhe datën e testimit vlerësues, dhe njofton nxënësin.
7. Me arritjen e pikëve për notë kaluese në testin vlerësues, nxënësi fiton të drejtën për regjistrim në profilin e caktuar, përkatësisht në shkollën përkatëse.
8. Për regjistrimin apo mosregjistrimin e nxënësit, drejtori i shkollës nxjerr vendim përkatës.
9. Drejtori i shkollës e njofton DKA për secilin rast të pranimit të nxënësve sipas procedurave të caktuara, me specifikim (emri i nxënësit, klasa, shkolla nga ka ardhur, fillimi i vijimit të mësimi, etj.)
10. Nxënësi i pakënaqur me vendimin e drejtorit të shkollës ka të drejtë ankese në Komisionin e Ankesave në DKA si shkallë e parë, në afat prej 6 (gjashtë) ditësh dhe në MASHT si shkallë përfundimtare në afat prej 3 (tri) ditësh nga dita e pranimit të vendimit nga shkalla e parë.

## **Neni 5**

### **Dispozitat shfuqizuese**

Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi shfuqizohet udhëzimi administrativ numër: MASHT(I) 38/2006: Kalimi i nxënësit të shkollës së mesme të lartë prej një profili arsimor në tjetrin ose prej një shkolle në shkollën tjetër.

## **Neni 6**

### **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ana e ministrit.



**Prof. dr. Ramë Buja, ministër**

